



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 8
Prishtinë, më 25 maj 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Shaip Muja, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Amir Ahmeti, munguan: Enis Kervan, Sabri Hamiti dhe Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Saniye Berisha – OSBE dhe Shkelzen Lushaku- KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të 11 dhe 13 maj 2011;
3. Diskutim për iniciimin e një Instituti Kombëtar të Diasporës bashkë me Shqipërinë dhe Maqedoninë;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të 11 dhe 13 maj 2011;

Kryetari konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e 11 dhe 13 maj 2011, me propozimin e deputetit H. Hyseni që në procesverbal të mos përfshihen edhe përflijet e diskutimeve të deputetëve.

3. Diskutim për iniciimin e një Instituti Kombëtar të Diasporës bashkë me Shqipërinë dhe Maqedoninë

Albin Kurti - Tha se krijimi i një Instituti të përbashkët për Diasporë në mes të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë është gjithsesi i nevojshëm. Një institut i tillë do të merrej ekskluzivisht me çështjet dhe nevojat e diasporës, si dhe me integrimin dhe rritjen e bashkëpunimit mes diasporës dhe Kosovës, Shqipërisë e Maqedonisë. Ky institut do të vepronte nën udhëheqjen politike të

qeverive përkatëse dhe do të ishte përgjegjës për koordinimin e politikave qeveritare e shtetërore për diasporë, si dhe për hulumtime e analiza të ndryshme rreth saj.

Arsyet për krijimin e një instituti të përbashkët tha se janë këto: Diaspora është një temë që preokupon qytetarët e të tri vendeve, diaspora e të tri vendeve përbëhet me shumicë nga pjesëtarët e kombit shqiptar. Shqiptarët jetojnë të ndarë nëpër këto tri shtete në Ballkan, mirëpo ata jetojnë e punojnë bashkë në mërgim. Diaspora e të tri vendeve perceptohet në vendet mikpritëse si shqiptare, pavarësisht se prej cilit prej këtyre tri vendeve vjen ajo. Diaspora e të tri vendeve tona perceptohet në vendet e mikpritjes si problematike dhe gëzon një reputacion të keq gjë që ka një ndikim negativ si në raport me qëndrimin e shteteve mikpritëse ndaj qytetarëve të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, ashtu edhe në raport me vetë këto vende. Një Institut i përbashkët tha se do të mundësonte: trajtimin e problemit nga perspektiva e rajonit, shkëmbimin e përvojës ndërshtetërore në lidhje me problemet në fjalë, koordinimin e politikës së vendeve të rajonit me vendet në të cilat shkojnë mërgimtarët, p.sh. në lëmin e integritit, bashkimit e resurseve për një problematikë të përbashkët etj. Ai në vazhdim paraqiti edhe detyrat e mundshme të Institutit, si në rrafshin nacional ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Hydajet Hyseni - Në diskutimin e tij tha se është mirë që Qeveria ka themeluar Ministrinë për Diasporën, pasi që kalimi i kësaj çështjeje nga Departamenti i çështjeve jo rezidente në kuadër të Ministrisë së Kulturës nuk ka mundur të japë efektet e duhura. Kjo çështje është shumë e rëndësishme dhe duhet shtruar, po ka edhe dilema lidhur me të. Dilemat ekzistojnë duke filluar nga terminologjia diasporë dhe mërgatë, se a është mërgata jonë çështje e politikës së jashtme, a është politikë e jashtme raporti institucional me mërgatën gjë që duhet shikuar nga aspekti multi institucional, si dhe a duhet formuar institut apo ndonjë formë tjetër të organizimit më pak institucionale për këtë çështje? Do të ishte mirë që edhe mërgata të gjejë formën e organizimit, që do ta lehtësonte angazhimin tonë në këtë drejtim. Propozoi që për këtë çështje të diskutohet me ministrin e diasporës dhe në bashkëpunim me mërgatën, të gjendet forma më e mirë që mërgata të ketë një përkrahje më të madhe institucionale.

Donika Kadaj- Bujupi - Tha se e përkrah fuqishëm këtë iniciativë dhe e konsideron se janë bërë lëshime ndaj diasporës, sidomos ndaj atyre të viteve të 90- ta e 2000, të cilët kanë mbetur në mes të Kosovës dhe vendit ku jetojnë. Ata nuk kanë asnjë dokumentacion të shtetit ku jetojnë, as mundësinë për t'u integruar, por edhe ne ju kemi pamundësuar të drejtën për të qenë shtetas të shtetit të tyre. Shtroi kërkesën për disa sqarime, si dhe ku do të themelohet ky institut, forma e buxheti i tij dhe koordinimi në mes të tri vendeve, me dëshirë që kjo iniciativë të jetësohet më shpejt.

Skender Hyseni - Tha se e përkrah këtë iniciativë, duke i pasur parasysh të gjitha implikimet, dilemat dhe shqetësimet të cilat mund të paraqiten. Kjo iniciativë është vështirë të realizohet shpejt, megjithatë sa më parë që të artikulohet ky projekt aq më shpejt edhe do të realizohet. Kjo iniciativë përveç me Maqedoninë dhe Shqipërinë mund të bisedohet edhe me Malin e Zi, për një institut të përbashkët. Qytetarëve tanë duhet t'ju japim privilegjet dhe mirënjohjet të cilat u atyre u takojnë. Kësaj iniciative mund t'i jepen ngjyrimet të llojllojshme dhe do të ketë pengesa në realizimin e saj, por kjo nuk do të thotë që iniciativa të mos dërgohet deri në fund.

Shaip Muja- Lidhur me krijimin e institutit për diasporën tha se duhet shtruar çështjen se a do të jetë ky institut i pavarur, si do të jetë selektimi, kush do të janë udhëheqësit e institutit nga këto vende dhe cilat do të jenë planet e punës së këtij instituti. Ne duhet t'i kemi të qarta së pari objektivat e Ministrisë së Diasporës, që tani është themeluar në mënyrë që të mos bëjmë dyfishim të punëve. Po ashtu duhet diskutuar se kjo iniciativë a duhet krijuar nga ndonjë shoqëri civile apo nga

institucionet? Iniciativën për krijimin e një instituti të diasporës të përbashkët me Maqedoninë Shqipërinë e Malin e Zi, tha se e përkrah në parim në interes të qytetarëve ku ata bashkëjetojnë bashkë, por duhet konsultuar edhe objektivat e Ministrisë së Diasporës.

Albin Kurti - Tha se pajtohem me z. H. Hyseni për dallimin ekzistues në mes të shprehjeve diasporës dhe mërgatës. Instituti për diasporë tha se, nuk do të ishte vetëm i Republikës së Kosovës, por do të ishte një institut i përbashkët. Një institut kombëtar i diasporës ekziston në Shqipëri, i cili gjendet në kuadër të MPJ. Krijimi i një instituti kombëtar për diasporën do të shtrinte bashkëpunimin me të gjitha shtetet ku gjenden mërgimtarët tanë, dhe do ta kishte mbështetjen më të madhe nga qeveritë e atyre shteteve, se sa që do të mund ta kishte MPJ-a. Dallimi në mes të një ministrie dhe një instituti është se ministrinë shpeshherë përfundojnë me menaxhimin e politikave e çështjeve urgjente e emergjente ditore, kurse instituti do të merrej me hulumtime sociologjike-kulturore me studime afatgjate, do të nxirrte trajektore të ndryshme të lëvizjeve demografike sociale e arsimore të diasporës sonë. Krijimi i këtij instituti kishte me qenë mirë të fillohet me Shqipërinë e më pas në faza, të zgjerohet edhe me Maqedoninë e Malin e Zi.

Lidhur me nevojën, objektivat, emërtimin dhe qëllimin për krijimin e një Instituti Kombëtar të Diasporës bashkë me Shqipërinë dhe Maqedoninë diskutuan deputetët H. Hyseni, S. Hyseni, A. Kurti dhe Sh. Muja.

Pas diskutimeve të deputetëve kryetari, konstatoi se Komisioni nxori këtë

Përfundimin

Miratohet në parim iniciativa për formimin e një Instituti Kombëtar të Diasporës bashkë me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Propozimi për formimin e Institutit do të nxirret në njërën nga mbledhjet e radhës së Komisionit.

4. Të ndryshme.

- 4.1.** Mbështetur në Planin e Programin e Punës, Komisioni vendosi që të ftohet ministri Enver Hoxhaj, që të njoftoj Komisionin lidhur me njohjet e reja, njëkohësisht dhe punën e misioneve diplomatike jashtë vendit, nga mesi i muajit qershor.
- 4.2. Hydajet Hyseni** - Tha se ka propozuar një ide që Komisioni të organizojë një tryezë lidhur me fushën të cilën e mbulon Komisioni, e që nuk është e përfshirë në Programin e Punës së Komisionit. Propozoi që një debat i tillë të mbahet, sepse do të ishte shumë pozitiv për Komisionin, dhe të gjendet termini i përshtatshëm për mbajtjen e tij.
- 4.3. Donika Kadaj -Bujupi** - Propozoi që Komisioni të organizojë një konferencë të natyrës jo vetëm rajonale, por edhe me pjesëmarrjen e komisioneve të shteteve të tjera evropiane që e mbështesin Kosovën në Prishtinë. Kosova ka nevojë të vizitohet nga të tjerët, që të shikohen mundësitë që i ka për zhvillim. Kjo konferencë, po ashtu do të ndikonte në përmirësimin e imazhit të Kosovës, pasi që ekziston një perceptim jo i mirë për të.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti